



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e premte, në datën 29 mars 2019, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Piro	MISHA	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar
Zylyftar	BREGU	Anëtar

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. “Miratimin e bilancit vjetor të Autoritetit të Mediave Audiovizive, për vitin 2018” **(Vendimi nr. 49, datë 29.03.2019)**
2. “Rinovimin e licencës së shoqërisë “Ora” sh.a., për subjektin audio privat “Radio Ora”. **(Vendimi nr. 50, datë 29.03.2019)**
3. “Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Sin Tel” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Sin-Tel”. **(Vendimi nr. 51, datë 29.03.2019)**
4. “Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “DIGIT-ALB” sh.a., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv dhe për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet satelitor”. **(Vendimi nr. 52, datë 29.03.2019)**
5. “Ndryshimin e të dhënave në strukturën e pronësisë së shoqërisë “DIGIT-ALB” sh.a.”. **(Vendimi nr. 53, datë 29.03.2019)**
6. “Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Radio Network Albania” sh.p.k., për ndryshimin e emrit të shërbimit të programit audio privat nga “Radio Hit Fm” në “Radio DJ 98.2”. **(Vendimi nr. 54, datë 29.03.2019)**
7. “Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Extra Channel” sh.p.k., për ndryshimin e emrit të subjektit nga “Extra Channel” në “In Tv Albania”. **(Vendimi nr. 55, datë 29.03.2019)**
8. “Pranimin e kërkesës së subjektit person fizik Altin Sharka, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “Tv Kabllor Hysgjokaj”, për zvogëlimin e zonës, duke hequr nga zona e ofrimit të shërbimit, “Njësinë administrative Ballgat”. **(Vendimi nr. 56, datë 29.03.2019)**
9. “Pranimin e kërkesës së subjektit person fizik Shaban Merkaj, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv kabllor Lapardha”, për zvogëlimin e zonës, duke hequr nga zona e ofrimit të shërbimit, “Njësinë administrative Vërtop”. **(Vendimi nr. 57, datë 29.03.2019)**

10. “Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të subjektit person fizik Besnik Deliu, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “Tv Kabllor KAM”. **(Vendimi nr. 58, datë 29.03.2019)**
11. “Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të subjektit person fizik Floresha Hymetllari, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “Tv Kabllor Hymetllari”. **(Vendimi nr. 59, datë 29.03.2019)**
12. “Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Net 3 Digital” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Net 3 Digital”, për azhurnimin e zonës së ofrimit të shërbimit nga “Njësia Administrative Belsh”, në “Bashkia Belsh” **(Vendimi nr. 60, datë 29.03.2019)**
13. “Pranimin e kërkesës së subjektit person fizik Emin Genica, duke kaluar të drejtat dhe detyrimet e autorizimit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve “Tv Pojan”, tek shoqëria “Tele.Co.Albania” sh.p.k.” **(Vendimi nr. 61, datë 29.03.2019)**
14. “Pranimin e kërkesës së subjektit person fizik Bardhyl Tosku, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “Tv Kabllor Asparag”, për zvogëlimin e zonës së ofrimit të shërbimit, duke hequr nga zona e ofrimit të shërbimit Njësiti administrative Gjocaj, Karinë, Tërbuf dhe Dushk.” **(Vendimi nr. 62, datë 29.03.2019)**
15. “Rrëzimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të AMA-s, nr. 186 datë 05.11.2018 “Për pranimin pjesërisht të ankimit administrativ të subjektit person fizik Dritan Memushi kundër vendimit nr. 20 datë 03.07.2018, të vendosur nga grupi i inspektimit ndaj subjektit OSHMA “Tv me Kabëll Tepelena Sat” nga 2,000,000 lekë në 1,000,000 lekë” **(Vendimi nr. 63, datë 29.03.2019)**

Tiranë, 29 mars 2019

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE